



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

Nr. 10/12 Prot.

Tiranë, më 30/10/2020

**V E N D I M**

*Nr.118, Datë 30/10/2020*

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**“Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut”**

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit nr. 10/6, datë 13.05.2020, Departamenti i Auditimit të Performancës realizoi auditimin e performancës me temë “Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut”. Ky auditim u programua për t’u ushtruar konkretisht në Ministrinë e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile e cila ka marrëdhënie me Sektorët e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në 12 prefekturat e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, ku në prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier e Vlorë auditimi u fokusua më shumë për arsye se në juridiksionin e tyre ato kanë plazhe në varësi; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe katër portet Durrës, Shëngjin, Vlorë e Sarandë në varësi saj; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë nga auditimi i mëparshëm; ndërsa Bashkia Shkodër e Fier si dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar janë njoftuar nëpërmjet shkresave informuese duke u përfshirë në këtë auditim në fazën marrjes së opinioneve në hartimin e programit të auditimit. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat nr. 10/10, datë 25.06.2020, u dërgua projekt-raporti i auditimit Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Drejtorisë Përgjithshme Detare, ndërsa porteve Durrës, Shëngjin, Vlorë e Sarandë si dhe prefekturave Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier e Vlorë projekt-raporti ju dërgua në formë elektronike, për të përthithur sa më shumë opinione dhe observacione në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të mjedisit, me fokus kryesor “Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut.

Raporti i auditimit është hartuar vetëm mbi bazën e Projekt-raportit i cili është realizuar pasi janë shqyrtuar e marrë parasysh të dhënat sipas pyetësorëve dhe shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të trajtuar në mënyrë të hollësishme si dhe pasi subjektet e audituara kanë shprehur dakordësishtë për Projekt-raportin.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të

Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

## **K O N K L U D O V A:**

Në politikat shoqërore të një vendi, vend të rëndësishëm zë ngritja e një sistemi sa më cilësor të në shërbim të qytetarit.

Zonat detare sigurojnë benefite të rëndësishme për njerëzit përsa i përket ushqimit dhe shërbimeve të tjera të ekosistemit. Për mijëra vjet, njerëzit e kanë shfrytëzuar gjerësisht detin si një depozitë të madhe ushqimore në luftën e tyre për mbijetesë.

Duke e parë edhe në këtë kontekst sot sfida e mbrojtjes deteve nga ndotjet në përgjithësi por dhe të menjëhershme qëndron në menaxhimit e tij në mënyrë gjithë përfshirëse duke ofruar përfitime të barabarta, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore të BE-së. Menaxhimi sa më efikas i deteve qëndron në rritjen e transparencës dhe bashkëveprimit të shumë institucioneve, sepse ka të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës e shërbimeve, me rendin ligjor, vetëdijen qytetare dhe me qeverisjen në tërësi. Administrimi dhe menaxhimi i ujërave të deteve nga ndotjet nënkupton, ruajtjen, përdorimin e burimeve natyrore e biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit, zhvillimin e biznesit etj.

Auditimi i performancës me teme "Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut" u iniciua nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë si bashkëpunim rajonal me zyrat supreme të auditimit të Sllovenisë, Italisë, Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Shqipërisë që filloi nëpërmjet një takimi të parë mbajtur në Kroaci i cili do të pasohej edhe me takime të tjera, të cilat nuk u finalizuan plotësisht për shkak të pandemisë globale. Megjithatë u ra dakord që secila nga zyrat të paraqesë auditimin e saj të pavarur nga ku do të realizohet një material përmbledhës me të gjitha problematikat sipas SAI-ve pjesëmarrëse. Ndonëse në vendet tona që lagen të gjitha nga deti Adriatik ndërsa deti Jon vendi ynë e Italia, nuk kanë ndodhur ngjarje të përmasave të tilla që të klasifikohen si emergjenca mjedisore, rritja e aktivitetit tregtar, zhvillimi i vendeve tona që lagen nga këto dete dhe faktorët mjedisorë që gjithnjë e më tepër po impaktojnë negativisht klimën globale e atë rajonale, mund të shpien në katastrofa mjedisore, përmasat e të cilave mund të shumëfishohen, për specifikën që ka karakteri i mbyllur i detit Adriatik dhe mos marrja në kohë e masave parandaluese e të ndërhyrjes së shpejtë. Gjithashtu trajtimi i kësaj teme auditimi nga të gjitha SAI-et rajonale, nën optikën e auditimit të performancës është i rëndësishëm, veçanërisht pasi mbrojtja e ujërave detare nga ndotjet është me ndikim të madh në mjedisi, florën e faunën detare, në zhvillimin e turizmit, në të ardhurat e ekonomisë në tërësi si dhe me ndikim në shëndetin e popullsisë.

Shqipëria ka një vijë bregdetare prej 476 km të gjatë: 325 km në perëndim në detin Adriatik dhe 151 km në jugperëndim në detin Jon. Deti Adriatik dhe deti Jon kanë rëndësi të madhe gjeografike dhe ekonomike. Ato ndikojnë në zbutjen e klimës, në ujërat e tyre gjuhet një sasi e madhe peshku dhe në laguna nxirret kripë. Këto dete shërbejnë edhe si rrugë lidhëse të Shqipërisë me shtetet e tjera fqinje. Ekosistemet detare dhe ligatinat bregdetare të Shqipërisë janë të pasura me tipologji habitatesh dhe biodiversitetin shoqëruar. Ato përbëjnë një pjesë të

rëndësishme të trashëgimisë natyrore jo vetëm për vendin por gjithashtu edhe për rajonin e Mesdheut në tërësi.

Nëpërmjet këtij auditimi ne kemi synuar të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse, në rritjen e besimit qytetar, në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit, monitorimit, administrimit të mbrojtjes së detit sepse në shumë raste mënyra e menaxhimit dhe bashkërendimit të institucioneve shtetërore maten vetëm me shifra, por harrojmë se mënyra sesi ato menaxhojmë shërbimet, reflekton qasjen sociale për brezat e ardhshëm.

Çdo person, kushdo qoftë, bashkëjeton me mjedisin, por jo të gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëllon ndaj tij, prandaj është detyrë e të gjithëve por edhe e jona si KLSH që të synojnë në nxitjen e veprimeve të menjëhershme e përcaktojnë një reflektim mbi pasojat e veprimtarisë njerëzore në mjedis se ku po shkon niveli i ndotjes, për të bindur institucionet shtetërore, biznesin, komunitetin dhe qytetarin, që :

- të kuptojë ç' është ndotja e mjedisit;
- të njohë ndotjen e tokës;
- të tregojmë ç' është ndotja e ujërave detare;
- të tregojmë nivelin e ndotjes së ujit, shkaqet;
- të japim rëndësinë ligjit në mbrojtjen e mjedisit duke shprehur legjislacionin përkatës;
- të tregojmë realisht nivelet e ndotjes bazuar në statistika;
- të japim disa masa që mund të merren për pakësimin e ndotjes;
- të tregojmë fakte mbi ndotjen dhe masat që merren në zonën ku jetojmë;
- të japim rekomandime për institucionet shtetërore dhe sensibilizuese për dëgjuesin.

Gjithashtu dhënia e opinionëve tona në përmirësimin, modernizimin e sistemit të mbrojtjes deteve nga ndotjet e menjëhershme, është prioritarë sot më shumë sepse nuk është plotësisht në harmoni me kërkesat e sotme në drejtim të:

- bashkëveprimin të institucioneve në drejtim të reduktimit të riskut për ndodhjen e katastrofave të menjëhershme në det duke përfshirë të gjithë aktorët/faktorët e interesuar;
- nevojave për miratimin dhe zbatimin e “Strategjisë ndër sektoriale kombëtare për mbrojtjen mjedisore të ujit deteve”;
- nevojave për përmirësimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile;
- nevojave për përmirësimin e Planit Kombëtar të Emergjencave “Për reagimin ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë”
- nevojave për përmirësimin e mekanizmave zbatues dhe krijimit të kapaciteteve për shkak të qasjeve të ndryshme sektoriale;
- angazhimit të pamjaftueshëm të një numri institucioneve shtetërore në bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë në ruajtjen e detit dhe vijës bregdetare nga ndotjet
- varësisë ende të lartë nga mbështetja e huaj në raste emergjente;
- krijimit të një qasje gjithëpërfshirëse dhe zhvillimit të një mjedisi më të favorshëm ligjor dhe institucional në përthithjen e investitorëve vendas dhe të huaj për përmirësimin e kapaciteteve logjistike në mbrojtje të detit nga ndotjet;

**Qëllimi i auditimit:** është përmirësimi i bashkëveprimin të gjitha palëve, për të nxitur, rëndësinë strategjike në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, mbrojtjen civile dhe ruajtjen e mjedisit detar nga ndotjet e ndotësit dhe respektimin e standardeve.

**Objektivi i auditimit:** është për të rritur përgjegjësitë institucionale të strukturave shtetërore e vendore në analizimin me objektivitet të situatave të papritura me pasoja negative për mjedisin detar e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

**Rëndësia e auditimit:** është vlerësimi i performancës institucioneve shtetërore, përsosja e monitorimit e inspektimit, modernizimi i standardeve, rritja e besueshmërisë publike, për mbrojtjen e mjedisit në ujërat detare, në funksion të ruajtjes shëndetit njeriut, florës dhe faunës detare zhvillimit të turizmit, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomive që kanë lidhje me detin.

**Mesazhi kryesor i këtij auditimi është:** *“Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të krijojë një qasje të re ligjore të bashkëpunimit me institucionet qendrore, pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen dhe forcimin e rrolit të saj koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin*

***Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë auditimit janë;***

Me gjithë punën e bërë dhe reformat e ndërmarra nga institucionet shtetërore sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit në mbrojtje të mjedisit, zhvillimit të ekonomisë detare dhe turizmit, në mbrojtje të florës dhe faunës në dete vazhdon të kenë mangësi sepse:

- ✘ nuk është hartuar strategjia për mbrojtjen civile si dokumenti bazë që përcakton politikat dhe objektivat, për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas me qëllim garantimin e mbrojtjes e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile;
- ✘ në krijimin dhe inkurajimin e një kulture të mbrojtjes civile, çka mundëson reduktimin e riskut për një diapazon të gjerë fatkeqësish duke përfshirë të gjithë aktorët/faktorët e interesuar;
- ✘ planet përkatëse vuajnë mungesën e mekanizmave zbatuese, ndërsa krijimi i kapaciteteve ka mbetur prapa për shkak të qasjeve të ndryshme sektoriale dhe angazhimit të pamjaftueshëm të një numri institucioneve shtetërore, por edhe të varësisë ende të lartë nga mbështetja e huaj;
- ✘ në Ministrinë e Brendshme nuk u krijuar asnjëherë në formën e plotë të departamentit Departamenti i Planëzimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile;
- ✘ në ri hartimin dhe freskimin e Planit Kombëtar për Përballimin e Emergjencave Civile në bashkëpunimin me institucionet e tjera;
- ✘ në hartimin e planeve për plotësimin dhe freskimin e rezervave të emergjencave civile, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile;
- ✘ në përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e akteve nënligjore për planifikimin dhe përballimin emergjencave civile;
- ✘ në bashkërendimin e punës midis institucioneve qendrore me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile ;
- ✘ në organizimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile ;

- ✘ në përpunimin dhe ndjekjen e programeve të edukimit publik dhe të trajnimit të strukturave, shtetërore dhe jo shtetërore në fushën e mbrojtjes civile ;
- ✘ në udhëzimin e strukturave përgjegjëse për mënyrën e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të opinionit publik për emergjencat civile;
- ✘ në kontrollin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile, pranë subjekteve shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit;
- ✘ në kontrollin e mënyrës përdorimit të burimeve, materiale e financiare, që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave civile, për organet, qendrore dhe vendore;
- ✘ në kontrollin e shpërndarjes dhe mënyrës përdorimit të mallrave rezervë emergjente, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe me aktet, ligjore dhe nënligjore, në fuqi;
- ✘ në organizimin e grupeve ndërministrrore të monitorimit për mënyrën e menaxhimit të sistemit të emergjencave civile;
- ✘ në drejtimin dhe komandimin në mënyrë të përqendruar të gjitha kapacitetet njerëzore dhe logjistike të parashikuara në planet e përballimit të emergjencave civile;
- ✘ DPEC, si pjesë përbërëse e strukturës së Ministrisë së Brendshme e së fundmi si institucion varësie i Ministrisë së Mbrojtjes, (AKMC) nuk ka patur një rregullore të brendshme të funksionimit të saj;
- ✘ AKMC nuk është plotësisht në efikasitet, deri sa të vihen në funksion institucionet e reja sipas ligjit të ri për “Mbrojtjen Civile”, që ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2019 si dhe aktet nën ligjore që e plotësojnë atë të cilat kanë afat maksimal deri në fund të 2021;
- ✘ buxheti se për DPEC-së kur varësia e saj ka qenë nga Ministria e Brendshme ashtu dhe kur së fundmi me emërtimin e ri AKMC e cila është në varësi të Ministrisë Mbrojtjes në bazë të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, nuk ka qenë i ndarë më vete por ka qenë dhe është pjesë e buxhetit të ministrisë së linjës;
- ✘ numri i punonjësve të DPEC të miratuara sipas strukturës dhe organikës së Ministrisë së Brendshme ka qenë shumë i ulët krahasuar me detyrat e ngarkuara nga ligji;
- ✘ AKMC ka mangësi në numrin e punonjësve, sepse deri në momentin e hartimit të projekt raportit ka 15 punonjës nga 106 punonjës që duhet të ketë ose me mangësi prej 91 punonjësish;
- ✘ AKMC deri në momentin e hartimit të projekt raportit nuk ka krijuar 6 drejtori kryesore me sektorët përkatës dhe 3 sektorë në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Përgjithshëm të agjencisë, gjithashtu nuk ka krijuar edhe 4 drejtori rajonale në të gjithë vendin;
- ✘ AKMC nuk ka të dhënave për mbrojtjen e deteve nga ndotjet nga nafta ose lëndë të rrezikshme e të menjëhershme me pretendimin se “....ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Plani Kombëtar për emergjencat civile dhe “Vlerësimi i rreziqeve”, nuk i përfshijnë mbrojtjen e deteve nga ndotjet, pra nuk janë fushë përgjegjësie e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile”;
- ✘ në marrjen e masave konkrete për ndryshimin e fushës së përgjegjësive për emergjencat dhe mbrojtjen civile sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë ministrinë edhe sipas emërtimeve të reja;
- ✘ nuk funksionojnë plotësisht zyra (ZIMEK) sepse pas miratimit të strukturave të reja në ministrinë e linjës, këto zyra janë zëvendësuar me këshilltarë për emergjencat pranë kabinetit të Ministrisë;

- ✘ në paraqitjen e të gjitha planeve të emergjencave dhe mbrojtjes civile nga institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor;
- ✘ DPEC së fundmi AKMC nuk paraqet shumë raporte të kontrollit dhe inspektimit për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në rastet e emergjencave dhe mbrojtjes civile;
- ✘ DPEC së fundmi AKMC nuk ka plane për rishikimin, përditësimin dhe përmirësimin e Planit Kombëtar për Përballimin e Emergjencave Civile, megjithëse në aktet nënligjore të ligjit nr. 45 “Për mbrojtjen civile” është parashikuar miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, çka nënkupton një përditësim të planit ekzistues, por në përputhje me vizionin dhe kërkesat e ligjit të ri;
- ✘ DPEC së fundmi AKMC nuk ka të dhëna për hartimin, përpunimin dhe zbatimin e kurikulave të trajnimit në fushën e emergjencave dhe mbrojtjes civile;
- ✘ DPEC së fundmi AKMC nuk ka të raporte, analiza dhe informacione të kontrollit mënyrës përdorimit të burimeve, materiale e financiare, që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave dhe mbrojtjes civile;
- ✘ DPEC së fundmi AKMC nuk ka sistem të dhënash statistikore se si menaxhon, organizon dhe monitoron në nivel kombëtar dhe vendor për emergjencat dhe mbrojtjes civile sepse këto të dhëna statistikore nëse edhe në formatin e paplotësuar nuk paraqiten;
- ✘ në mos kryerjen e veprimeve të menjëhershme operative për eliminimin e ndotjeve në rastet e njoftimeve që vijnë nga vendet fqinjë, sepse nga të dhënat rezulton që masat për eliminimin e tyre janë marrë po nga këto vende që kanë njoftuar;
- ✘ në dobësinë e strukturave ligj zbatuese për të vepruar në hapësirën detare për eliminimin e ndotjeve detare për arsye të:
  - mungesës një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare ose pajisjeve alternative për detektimin e ndotjeve;
  - mungesës veprimeve të shpejta dhe në kohën e duhur, për të marrë nën kontroll dhe ndaluar rrjedhjet e karburanteve dhe lëshimit të substancave të rrezikshme kimike;
  - mos marrjes informacionit në kohë dhe pamundësia për prezencë me shërbim 24-orë me mjetet në të gjithë hapësirën detare shqiptare, si formë alternative për zbulimin e ndotjeve në kohë reale;
  - vështirësisë për të zbuluar shkaktarët e ndotjes si rezultat i mungesës së laboratorëve sipas standardeve evropiane;
  - mungesës mjeteve lundruese apo ekzistenca e atyre pak që janë me kapacitete të vogla operacionale të cilat përdoren për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja;
  - mungesës në QNOD të Koordinatorit Kombëtar të Mjedisit me prani të përditshme për ndjekjen e gjithë problematikave që lidhen me ndotjet detare;
  - vështirësive në identifikimin e zonave me rrezikshmëri të lartë të aksidenteve me ndotje detare;
  - vështirësive në identifikimin nëpërmjet skemave të zonave me prioritet për mbrojtje dhe pastrim në rast të aksidenteve dhe katastrofave detare;
  - mangësive në sigurimin e një niveli minimal, të ekzistencës paraprake të llojeve të përshtatshme të veglave/pajisjeve që do të përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme me qëllimin që të garantojë minimizimin e menjëhershëm të ndotjes si rezultat i aksidenteve apo katastrofave detare;
  - mungesës mundësive për kryerjen e ushtrimeve të reagimit ndaj aksidenteve apo katastrofave detare nga ndotjet detare me naftë apo substanca të rrezikshme;



- etj.
- ✘ procesi i marrjes së masave nga prefekturat për mbrojtjen e detit nga ndotja ka filluar shumë më vonë;
- ✘ prefekturat nuk kanë mundësuar procesin e rishqyrtimit të planeve të emergjencave;
- ✘ prefekturat nuk disponojnë të dhëna lidhur me ndotjen e detit nga nafta ose mbetje të rrezikshme dhe mënyrat e ndërhyrjes në këto raste për zonat e kontaminuar në det;
- ✘ prefekturat nuk kanë të parashikuar në buxhetin e saj burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, në rastet e emergjencave dhe mbrojtjes civile nga fatkeqësitë dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme;
- ✘ prefekturat nuk kanë personelin e nevojshëm dhe të trajnuar që të realizojë organizimin, bashkërendimin e veprimtarisë në rastet e emergjencave e mbrojtjes civile dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme;
- ✘ prefekturat nuk kanë mjete për përballimin e rasteve të emergjencave civile në inventarin e tyre si dhe mjetet e nevojshme për përballje të parë me rastet emergjente dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme;
- ✘ në prefektura rezulton të ketë ndotje së detit nga mbetjet urbane, ujërat e përdorura (zeza), nafta dhe nënproduktet e saj, mbetje të rrezikshme, etj., si rezultat i prurjes tyre nga ujërat e lumenjve;

***Disa nga konkluzionet janë;***

- hartimi i strategjive është i rëndësishme sepse nëpërmjet tyre arrihet modernizmi i sistemit të mbrojtjes civile me synimin e:
  - përfshirjes së të gjitha konventave, iniciativave, marrëveshjeve dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike etj.;
  - parashikimit të gjitha detyrave dhe përgjegjësisë të institucioneve qendrore e lokale, subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve;
  - detyrimit dhe forcimit të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile;
  - detyrimit ligjor për të gjitha institucionet publike, subjektet private, në modernizmin e sistemit të mbrojtjes civile;
  - forcimit e funksionimit të mekanizmit të inspektimit për kontrollin e detyrave dhe përgjegjësisë të aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile;
  - rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kërkesën, marrjen, pranimin, dhënien dhe kalimin e kufirit shtetëror të asistencës ndërkombëtare;
  - rritjes së bashkëpunimit të gjitha institucioneve dhe strukturave në nivel qendror e vendor, shtetasit, subjektet private, organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile, institucionet kërkimore-shkencore, universitetet, organizatat vullnetare, organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin, nëpërmjet përcaktimit të drejtave dhe detyrave të qarta për secilin prej tyre;
  - rritjes së rolit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit, alarmit, krijimit dhe të ruajtjes së bazës të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në menaxhimin e fatkeqësive,
  - rritjes së rolit të organeve të pushtetit qendror e vendor në qarqe në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;

- planifikimit të fondeve financiare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile nga ana e ministrive dhe bashkive dhe përmirësimit të sistemit të financimit;
- përmirësimit thelbësor të sistemit të edukimit dhe trajnimit të punonjësve dhe individëve në rritjen e kapaciteteve të tyre;
- marrjes së masave konkrete të sensibilizimit të gjithë shoqërisë, për mbrojtjen civile si një detyrë e secilit nëpërmjet rritjes së rolit të gjithë aktorëve shtetërorë;
- planifikimit dhe realizimi sa më cilësor të masave parandaluese nga fatkeqësitë dhe atyre rehabilituese në infrastrukturë;
- Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes civile nëpërmjet përshtatjes saj me standardet evropiane, krijon mundësi për:
  - zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, nëpërmjet identifikimit të saktë, vlerësimit periodik dhe monitorimit të tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, duke investuar në parandalimin e risqeve, duke intensifikuar bashkëpunimin e të gjitha subjekteve si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre, nëpërmjet parashikimit të masave, në funksion të realizimit të tij;
  - forcimin e sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet krijimit të institucioneve me një autoritetet të lartë koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin;
  - forcimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile në tërësinë e tij, nëpërmjet përcaktimit më qartë të rolit dhe përgjegjësive të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor;
  - integrimin e prioriteteve, i qëllimeve dhe i objektivave të kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor, si dhe masave të tjera;
  - përmirësimin e edukimit për mbrojtjen civile, nëpërmjet përfshirjes së lëndëve përkatëse arsimore në nivelin arsimor parauniversitar;
  - përmirësimin e sistemit të paralajmërimit, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, duke përcaktuar detyrat për institucionet përgjegjëse dhe subjektet private;
  - vendosjen e rregullave më të qarta të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij ndërinstitutional në kuadër të asistencës ndërkombëtare dhe të procedurave përkatëse;
  - rritjen e rolit ndërkombëtar të Shqipërisë në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, nëpërmjet rolit më të madh dhe më aktiv të saj dhe përmbushjes së kontributeve në BE, NATO, OKB, OSBE etj.;
  - që çështja e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë të jetë një çështje e secilit sikurse të gjithë shoqërisë, nëpërmjet rritjes së rolit të gjithë aktorëve shtetërorë, individëve dhe subjekteve private në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe nëpërmjet përcaktimit të drejtave e detyrave që ato kanë në këtë fushë;
  - planifikimin dhe realizimin sa më cilësor i masave strukturore dhe jostrukturore në fushën e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, me theks të veçantë te masat parandaluese nga fatkeqësitë dhe atyre rehabilituese në infrastrukturë;



- zbatimin më i mirë i detyrave dhe i përgjegjësive të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet sanksionimit të kundërvajtjeve administrative, zbatimi i të cilave do të kontrollohet nëpërmjet inspektimit që do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
- Ruajtja e mjedisit ka të bëjë me, përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit, ruajtjen e florës dhe faunës natyrore detare si dhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit, administrimit, hartimit të politikave, konsiderimit të popullsisë në zonat detare si faktor i rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj pasurie kombëtare natyrore e duke i përfshirë ata në vendimmarrje dhe hartimin e planeve të administrimit të integruar për mbrojtjen e tij. Të gjitha këto bëjnë të mundur që, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos të turizmit, biznesit, të rriten ndjeshëm të ardhurat e banorëve vendas, të përmirësohet cilësia e jetës së tyre dhe ruajtjen e ujërave detare si trashëgimi për brezat;
- Monitorimi i ujërave detare është shumë i rëndësishëm për të arritur edhe objektivat e BE në minimizimin e ndotjeve që vijnë nga plastika, derdhja e mbetjeve urbane, vajrat dhe hidrokarburet, mbeturinat e peshkimit, ruajtjen dhe zhvillimin e zonave turistike ruajtjen e florës dhe faunës, etj., prandaj duhet që të monitorohen të analizohen gjithë faktorët që të mundësojë:
  - të kryejë vlerësimin e faktorëve ekspozues të ndotjeve, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga efektet negative të ndotjes;
  - të evidentojë vendet me rrezikshmëri më të lartë të ndotjes ujërave detare;
  - të përcaktojë burimet direkte dhe indirekte të ndotjes;
  - të japë rekomandimet përkatëse për reduktimin e ndotjes në vendet e identifikuara si të tilla dhe të shmangies së katastrofave detare;
  - të krijojë bazë të dhënash lidhur me gjendjen e mjedisit në det dhe zonat bregdetare të monitoruara, për krahasimin e tyre në vite;
  - të bëjë interpretimin shkencor të dhënave të grumbulluara nga monitorimi që t'u shërbejë autoriteve kompetente qendrore e vendore vendim marrëse, për mirë menaxhimin e ujërave tona detare dhe zonave bregdetare me synim nxitjen e zhvillimin e biznesit në ujërat e detit, turizmit ujqor e bregdetar, mbrojtjes së florës dhe faunës në det si faktorë kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit tonë në të ardhmen;
  - të sugjerojë plotësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së ujërave.
- Bashkëpunimi midis institucioneve është shumë i rëndësishëm nëse ndodh derdhje e menjëhershme karburanti ose substancave të rrezikshme sepse do të bëjë të mundur që të :
  - minimizojë, dhe kur është e mundur të ndalojë ndotjen e mëtejshme nga derdhja e karburantit ose e substancave të rrezikshme dhe helmuese në det;
  - marrë të gjitha masat e nevojshme për mbledhjen e pastrimit e karburantit apo substancave të rrezikshme dhe helmuese në përputhje me planet reaguese;
  - ndër marrë hapat e nevojshëm, përfshi dhe marrjen e mostrave, për identifikimin e burimit të derdhjes;
  - parandalojë çdo derdhje të mëtejshme që mund të ndodhë;
  - minimizojë, dhe kur është e mundur, ndalojë përhapjen e ndotësit;
  - zvogëlojë çdo efekt të dëmshëm nga derdhja;

- mbrojtje burimet, zonat dhe speciet e rrezikuara;
- monitorojë efektet e rrjedhjes;
- marrë parasysh këshillat e ekspertëve të përshtatshëm dhe të kualifikuar;
- pastrojë dhe heqë ndotjen;
- sistemojtë mbetjet e mbledhura në mënyrë të përshtatshme;
- mundësojtë garantimin e shëndetit dhe sigurisë së publikut, aktivistëve dhe çdo personeli që merr pjesë në reagimin ndaj derdhjes.
- Strukturat ndërinstitucionale bashkërenduese, kanë për detyrë organizimin, planëzimin dhe drejtimin e operacioneve detare, në të gjithë hapësirën detare, në rastet e ndotjeve detare, në përputhje me legjislacionin detar vendas e ndërkombëtar që të bashkërendojnë:
  - operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të dhënies së ndihmës në det, parandalimit e mbrojtjes mjedisin detar nga ndotja;
  - garantimin e bashkëpunimit efikas të gjithave institucioneve pjesëmarrëse;
  - garantimin e të gjitha burimeve të disponueshme, si mjetet detare, ajrore e tokësore, sistemet, personelin etj.;
  - përgatitjen dhe rekomandimet e nevojshme për trajnimin profesional, kualifikimet dhe arrijten e standardeve të kërkuara nga të gjitha institucionet e përfshira në operacionet detare.
- Mungesa e fondeve, vlerësimit të gjendjes së treguesve, mungesa e kapaciteteve njerëzore, trajnimeve, etj., janë problemi kryesor për zbatimin planeve të veprimit, të cilat mbeten çështje komplekse që mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet bashkëveprimit institucional qendror e lokal, me anë të përmirësimit të interesit dhe kapaciteteve brenda kuadrit të politikave integruese si vend aspirues për në BE, çka kërkon:
  - koordinim të përmirësuar horizontal dhe vertikal të komunikimit (p.sh. komunikimi brenda sektorit dhe komunikimi ndër-sektoriale),
  - zgjidhjen e çështjeve legjislative dhe juridiksionit të strukturave (p.sh. adresimin e plotë të strukturave që menaxhojnë, që mbrojnë, që monitorojnë dhe që do të kenë qasje në sistemin e të dhënave).

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi:

## **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Ndotja e menjëhershme e Jonit dhe Adriatikut”, të ushtruar konkretisht në Ministrinë e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile e cila ka marrëdhënie me Sektorët e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në 12 prefekturat e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, ku në prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier e Vlorë auditimi u fokusua më shumë për arsye se në juridiksionin e tyre ato kanë plazhe në varësi; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe katër portet Durrës, Shëngjin, Vlorë e Sarandë në varësi saj; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë nga auditimi i mëparshëm; ndërsa

Bashkia Shkodër e Fier si dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar janë njoftuar nëpërmjet shkresave informuese duke u përfshirë në këtë auditim në fazën marrjes së opinioneve në hartimin e programit të auditimit.

**II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:**

**Rekomandimi 1.**

- ✓ AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të koordinojë dhe bashkërendojë punën për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe rifreskimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, përfshirja në to e mbrojtjes së mjedisit në tërësi dhe ruajtjes së mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotjet e menjëhershme duke përcaktuar politikat dhe objektivat e zvogëlimit të risqeve nga fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë e për t'u rimëkëmbur.

**Menjëherë**

**Rekomandimi 2.**

- ✓ AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa:
  - në përgatitjen e plotësimin me akte nënligjore të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” si dhe ndjekjen e zbatimit e tyre për planifikimin dhe përballimin emergjencave civile;
  - në krijimin e drejtorive kryesore me sektorët përkatës, plotësimin me punonjës të agjencisë dhe krijimit të drejtorive rajonale;
  - të mundësojë koordinimin dhe dhënien e kontributeve në implementimin e suksesshëm të programeve dhe projekteve të ndryshme në fushën e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile.
  - të mundësojë forcimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të institucioneve qendrore dhe vendore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe sigurisë së jetës së qytetarëve;
  - të mundësojë forcimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe vendet e rajonit e më gjerë për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes civile dhe ndihmën e ndërsjellët në raste fatkeqësish;
  - të mundësojë rishikimin e planeve të emergjencave civile në 12 prefekturat e vendit dhe në çdo bashki;
  - të mundësojë hartimin e hartave të rrezikut dhe hartave shumë të rrezikshme të riskut;
  - të mundësojë bashkërendimin e punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
  - në organizimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile ;
  - në përpunimin dhe ndjekjen e programeve të edukimit publik dhe të trajnimit të strukturave, shtetërore dhe jo shtetërore në fushën e mbrojtjes civile ;
  - në udhëzimin e strukturave përgjegjëse për mënyrën e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të opinionit publik për emergjencat civile dhe mbrojtjen nga zjarri;
  - në kontrollin e zbatimit të masave mbrojtëse dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile, pranë subjekteve shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit;

- në kontrollin e mënyrës përdorimit të burimeve, materiale e financiare, që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave civile, për organet, qendrore dhe vendore;
- në kontrollin e shpërndarjes dhe mënyrës përdorimit të mallrave rezervë emergjente;
- në organizimin e grupeve ndërminstrore të monitorimit për mënyrën e menaxhimit të sistemit të emergjencave civile;
- në hartimin e rregullores brendshme të AKMC-së;
- të paraqitjes së planeve të emergjencave dhe mbrojtjes civile nga institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor.

### **Menjëherë e në vazhdimësi**

#### **Rekomandimi 3.**

- ✓ AKMC në bashkëpunim më Ministrinë e Mbrojtjes të mundësojë pozicionimin e saj në mbrojtje të mjedisit e veçanërisht mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotjet e menjëhershme në kuadër të bashkëpunimit me ministritë e institucionet e varësisë tyre dhe prefekturat.

**Menjëherë**

#### **Rekomandimi 4.**

- ✓ AKMC në bashkëpunim më Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për ndryshimin e fushave të përgjegjësisë në lidhje me emergjencat dhe mbrojtjen civile sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë ministritë sipas emërtimeve të reja.

**Menjëherë**

#### **Rekomandimi 5.**

- ✓ AKMC në bashkëpunim më Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masa për krijimin e strukturave të mbrojtjes civile pranë çdo ministrie sipas llojit të veprimtarisë e fushave që mbulojnë.

**Menjëherë**

#### **Rekomandimi 6.**

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Detare në bashkëpunim me Portet Shëngjin, Durrës, Vlorë e Sarandë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe QNOD-në të mundësojnë:
  - krijimin e një sistemi kombëtar për zbulimin e ndotjeve detare;
  - sigurimin e veprimeve të shpejta dhe në kohën e duhur, për të marrë nën kontroll dhe ndaluar rrjedhjet e karburanteve dhe substancave të rrezikshme;
  - krijimin e mundësisë për prezencë me shërbim 24-orë me mjete, në të gjithë hapësirën detare shqiptare, si formë alternative për zbulimin e ndotjeve në kohë reale;
  - marrjen e masave administrative ndaj të gjitha subjekteve që shkelin ligjin e ndotjeve detare;
  - krijimin e laboratorëve sipas standardeve evropiane për të zbuluar shkaktarët e ndotjes;
  - shtimin dhe rinovimin e mjete lundruese që përdoren për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja e për të shkuar në vendin e ndotjes;
  - vendosjen e përhershme të Koordinatorit Kombëtar të Mjedisit me prani të përditshme në QNOD, për ndjekjen e gjithë problematikave që lidhen me ndotjet detare;
  - përmirësimin e mënyrës koordinimit me strukturat përkatëse të reagimit në momentet e aksidenteve apo katastrofave me ndotje detare;
  - identifikimin e zonave me rrezikshmëri të lartë të aksidenteve me ndotje detare;

- sigurimin dhe shtimin e ekzistencës paraprake të llojeve të përshtatshme të veglave/pajisjeve që do të përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme;
- rritjen e fondeve buxhetore me qëllim të:
  - blerjes dhe përmirësimit shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve të specializuara për reagimin ndaj ndotjes;
  - sigurimit të mbështetjes logjistike të skuadrës së menaxhimit të incidentit;
  - planifikimit të shpenzimeve në lidhje me marrjen e masave reaguese, kur ndotësi nuk është identifikuar apo nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet e reagimit;
  - etj.
- trajnimin e personelit që merr pjesë direkt në reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në mënyrë të vazhdueshme si dhe hartimin e planeve, metodikave dhe kurikulave të përditësuara për trajnim;
- kryerjen e ushtrimeve për reagimin ndaj aksidenteve apo katastrofave detare nga ndotjet detare me naftë apo substanca të rrezikshme.

**Menjëherë e në vazhdimësi**

#### **Rekomandimi 7.**

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Detare të kryejë më shumë verifikime dhe kontrole në porte, instalime e pajisje datare që përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me naftë apo substanca të rrezikshme në kuadër të mbrojtjes së mjedisit detar.

**Menjëherë**

#### **Rekomandimi 8.**

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Detare në bashkëpunim më Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrinë e Mbrojtjes, QNOD-në, të mundësojë miratimin e reagimit të kombinuar ndaj ndotjeve detare jo vetëm me mjete detare por edhe me mjete ajrore të destinuara për zbulimin dhe eliminimin e ndotjeve vajore.

**Menjëherë e në vazhdimësi**

#### **Rekomandimi 9.**

- ✓ Prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier dhe Vlorë të bashkëpunojnë me AKMC, QNOD-në, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë e Mbrojtjes së Bregdetit, dhe Ministrinë e Brendshme, për të:
  - mundësuar rishqyrtimin e planeve të emergjencave për mbrojtjen civile dhe planin e emergjencave për reagim ndaj ndotjeve detare;
  - krijuar bazë të dhënash lidhur me ndotjen detare dhe mënyrat e ndërhyrjes në këto raste;
  - përmirësuar strukturën e Mbrojtjes Civile në shkallë qarku;
  - plotësuar dhe shtuar personelin me specialistë të fushës që trajtojnë emergjencat dhe mbrojtjen civile dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme mbrojtjen civile;
  - marrë masa konkrete në pajisjen me mjetet e nevojshme për përballje të parë me rastet emergjente dhe për rastet e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme;
  - rritur fondet buxhetore për eliminimin e ndotjes detit nga nafta ose lëndë të rrezikshme si në fazën e parë të situatës emergjente e deri në eliminimin e saj;
  - përmirësuar dhe rritur numrin e trajnimeve të strukturave të mbrojtjes civile në shkallë qarku;

- marrë masa konkrete për shmangien e ndotjes së detit nga mbetjet urbane, ujërat e përdorura (zeza), nafta dhe nënproduktet e saj, mbetje të rrezikshme, etj., si rezultat i prurjes tyre nga ujërat e lumenjve;
- përmirësuar kushtet e punës në funksion të veprimtarisë tyre si:
  - zyrë ose zyrë/sallë operationale, për marrjen, përpunimin dhe dërgimin e informacioneve, si dhe drejtimin e operacioneve në rastet e situatave emergjente;
  - pajisjet elektronike institucionale për komunikim, informim dhe përcjellje të situatave në kohë reale në të gjitha shkallët, qendrore e lokale;
  - mjete transporti për ndjekjen e situatës në terren dhe dhënien e ndihmës në vendngjarje;
  - uniformë të posaçme, dalluese për personelin e emergjencave dhe vullnetarët.

### **Menjëherë e në vazhdimësi**

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**KRYETARI**



**Arben SHEHU**